

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"CEPIM" SHPK**

Në Tiranë, sot me datë 21.01.2021, në respektim të kërkesave të ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, u hartua ky Akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me ortakë themelues si vijon:

1. **SHOQËRIA "CUPERSAFETY" S.R.L**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit italian në Regjistrin Tregtar pranë Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Bujqësisë së Barit, me nr. Regjistrimi 06597070728, me seli në adresën "Convesano (BA) Via Donatello 6 CAP 70014", e përfaqësuar nga Giuseppe Montanaro, shtetas italian, i biri i Nicola Montanaro, lindur më 08/10/1958, në Conversano (BA), Itali dhe banues në Conversano (BA) Italia në Rrugën Donato Iaia nr. 18, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimin italian nr. AS7392491.
2. **SHOQËRIA "INGEL" S.R.L**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit italian në Regjistrin Tregtar pranë Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Bujqësisë së Barit, me nr. Regjistrimi 04061820728, me seli në adresën "Convesano (BA) Via Mantova 23 CAP 70014", e përfaqësuar nga Anna Rita LESTINGI, shtetase italiane, e bija e di Stefano LESTINGI, lindur më 19/12/1966, në Conversano (BA), Itali dhe banues në Conversano (BA) Itali në Rrugën Magna Grecia n. 1/E,, madhore me zotësi të plota juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me letërnjoftimin italian nr. AY0283397.

Të cilët hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë "**CEPIM" SHPK**, duke u mbështetur në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshtë:

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqëria "**CEPIM" SHPK**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "CEPIM" shpk, është një shoqëri, që themelohet ndërmjet ortakëve të cilë mbulojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3 **Selia**

Shoqëria e ka selinë në Tiranë në adresën Pallati i Kulturës, Kati II, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 4 **Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:

- Elektronika e Përgjithshme;
- Projektim dhe prodhim të aparateve telefonikë dhe citofonie;
- Projektim dhe prodhim të aparateve TV me qark të mbyllur;
- Projektim dhe prodhim të aparateve të alarmit kundrazjarrit;
- Projektim dhe prodhim të sistemeve të telekontrollit;
- Projektim dhe prodhim të aparateve të kontrallit të nivelit të ujit;
- prodhim modulistik hapësinor;
- prodhim audioviziv;
- prodhim kompjutera;
- impiante të ajrit të kondicionuar;
- mirëmbajtje, projektim dhe realizim sistemesh hidraulike;
- ristrukturim dhe restaurim;
- mirëmbajtje e përgjithshme të ndërtesave civile dhe industriale; projektim, mirëmbajtje dhe realizim të sistemeve hidraulike;
- projektim dhe mirëmbajtje të sistemeve termikë;
- fusha e përgjithshme e impianteve;
- Aktivitet kërkimor si themelore ashtu edhe ato të aplikuar në fushën e shkencës kompjuterike dhe të të gjitha aplikacioneve të saj si dhe në fushën e elektronikës dhe të të gjitha aplikacioneve të saj.

Janë shprehimisht të përjashtuara të gjitha veprimtaritë profesionale për të cilat kërkohet një kualifikim i veçantë profesional, të cilat do të kryhen nga profesionistë të regjistruar në regjistrat specifik të cilat janë ngushtësisht profesional.

Shoqëria do të mund të përmbush të gjitha veprimet e luajtshme, të paluajtshme dhe tregtare me qëllim që të arrijë objektin e aktivitetit të shoqërisë, përfshirë edhe ndërmarrjen e operacioneve bankare; gjithashtu, kompania, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të marrë interesa, kuota, pjesëmarrje në kompani ose biznese të tjera, të themeluara ose që janë në proces themelimi, mund të realizojë blerje të filialeve ose degëve të kompanive të cilat kanë objekt aktiviteti të ngjashëm, të përafërt ose të lidhur me aktivitetin e saj, mund të marrë kredi, financime dhe të lëshojë garanci me

asete të luajtshme ose të paluajtshme reale dhe personale, duke përfshirë si garanci edhe lënien e kolateralit, për të garantuar detyrimet e tyre ose të kompanive në të cilat ata kanë, në mënyrë direkte ose indirekte, interesa, kuota ose i janë nënshtruar kontrollit të përbashkët, për sa kohë që nuk janë ndaj publikut.

Neni 5
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë “**CEPIM**” SHPK është e pakufizuar.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 euro (dhjetëmijë euro).

- a) Ortaku “**CUPERSAFETY**” **S.R.L** zotëron 1 (një) kuota me vlere nominale € 5.000,00, e cila përbën 50,00 % të kapitalit themeltar.
- b) Ortaku “**INGEL**” **S.R.L** zotëron 1 (një) kuota me vlere nominale € 5.000,00, e cila përbën 50,00 % të kapitalit themeltar..

Pjesëmarrja e kapitalit shoqëror nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Pjesëmarrja e ortakëve mund të jetë e shprehur në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

Neni 7
Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a)kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b)shitblerjes;
- c)trashëgimisë;
- ç)dhurimit;
- d)çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8 **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin në çfaredo banke apo institucion financiar kreditor.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 **Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga Administratori i Vetëm Z.Giovanni Fanelli shtetas italian, i biri i Vito Fanelli, i lindur më il 23/2/1958, në Conversano (BA), Itali dhe banues në Conversano (BA) Itali në Contrada vecchia Mola nr. 2, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nga letërnjoftimi italian nr. CA88508GA, sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rinovimi.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoret në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratoret shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 10 **Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes

Vendore, Zyrave te Punes, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 13
Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij akti themelimi, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe italiane, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "CEPIM" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
DELLA SOCIETA "CEPIM" SHPK**

CUPERSAFETY S.R.L.
Administrator i Vetëm
(Giuseppe Montanaro)



INGEL S.R.L.
Administrator i Vetëm
(Anna Rita LESTINGI)

